



Kom.Dh.Sh.II.nr.484/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Saranda Bogaj Sheremeti, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit J.... Sh.p.k me seli në Podujevë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve SCRL Partners Shpk, nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit Të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2747/18 të datës 05.02.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 03.11.2022, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit J.... Sh.p.k me seli në Podujevë, e datës 23.04.2021, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.2747/18 të datës 05.02.2021, Vërtetohet.

A R S Y E T I M

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative-Divizioni Fiskal, me aktgjykimin e ankimuar, ka Refuzuar kërkesë padin e paditësit, J.... Sh.p.k me seli në Podujevë, si të pabazuar, dhe ka lënë në fuqi aktvendimin e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë nr. 01.3.2.2/486,i datës 04.10.2018.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, me të cilin e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e paditësit e ushtruar ndaj aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamentit për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal A.nr.2747/18, sipas të cilit aktgjykim është refuzuar si e pabazuar kërkesë padia e paditësit dhe është lënë në fuqi vendimi i të paditurës. Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar një gjendje faktike të gabuar sipas nenit 183 të LPK-se, pasi gjykata është bazuar vetëm në mendimet tarifore të lëshuara nga e paditura pa u lëshuar fare në pretendimet e palës paditëse. Ndryshimi i numrit tarifor nga e paditura është bërë pasi malli ka dal nga mbikëqyrja doganore pa pasur mostrat dhe pasur një analizë të atyre mostrave, kjo tregon se e paditura ka shkelur dispozitat procedurale të përcaktuara edhe në kodin tarifor. Këtë fakt gjykata e shkallës së parë e ka anashkaluar. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur në kundërshtim me nenin 182 par. (n) të LPK-së.

Gjykata Komerciale-Dhoma e shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 dhe nenit 49 të LKA, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me Aktvendimin e organit të paditur nr.01.3.2.2/486 i datës 04.10.2018, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë, J.... Sh.p.k me seli në Podujevë, të ushtruar ndaj aktvendimit nr.03.1.1-2018-423 të datës 16.07.2018.

I pakënaqur me aktvendimin e të paditurit subjekti-tani paditësi, ushtron padi në procedurë të konfliktit administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ-Divizion Fiskal, duke kundërshtuar aktin administrativ përfundimtar të paditurës të lartcekur. Gjykata e shkallës së parë në këtë çështje, mbanë seancë të shqyrtimit kryesor me datë 26.01.2021, si në vështrim të nenit 81G të Ligjit 04/L-102, në prani të përfaqësueseve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, dhe pas administrimit të provave dhe vërtetimit të gjendjes faktike, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, ndërsa e lën në fuqi aktvendimin e organit të paditur, sipas theksimeve në arsyetim të aktgjykimit se: e paditura, Dogana e Kosovës pas marrjes së Mendimeve për Klasifikim Tarifore nga Sektori i Tarifës dhe të datës 12.09.2017, e të rikonfirmuara me Mendimet për Klasifikim Tarifor nr. dhe të datës 01.10.2018, si sektor i specializuar i cili vepron në kuadër të paditurës, me të drejtë ka konstatuar se në rastin konkret malli lëndor është dashur të tarifohet varësisht sipas përshkrimeve ku “në numrin-kodin tarifor, malli Gyp-Shpues Shtand vazhdues sonde” tutje “në numrin-kodin tarifor, malli shank adapter” dhe “ në numrin-kodin tarifor, malli kokë sonde” sipas të cilave numra për mallin e deklaruar duhet të paguhet taksa doganore prej 10% në vlerë dhe TVSH-ja, e jo të deklarohen në mënyrë grupore në një emërtim dhe atë në numrin, sipas të cilit numër malli është liruar nga pagesa e taksës doganore prej 10%. Deri te ky përfundim e paditura ka ardhur duke u bazuar në rregullat e përgjithshme 1-6 për interpretimin e TARIK-2015, e në bazë të shënimeve shpjeguese të seksionit XV dhe XVI kapitujve 73,82, shpjegimeve plotësueses informative nga interneti etj. Në kuptim të dispozitave ligjore nga neni 24 par. 1, nenit 82 par.1 të Kodit Doganor dhe të Akcizve, e paditura ka vepruar drejt kur paditësin e ka obliguar me detyrime doganore shtesë për shkak të deklarimit të pasakt të kodit tarifor për mallin e zhdoganuar përmes DUD-ave kontestues.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë. Aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Kodit doganor dhe të Akcizave dhe as me shkelje të tjera të dispozitave të LPK-së, sikurse pretendon në ankesë pala paditëse, të cilat Kolegji i vlerëson sipas detyrës zyrtare, si në vështrim të nenit 194 të LPK-së. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar - aktvendimit të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, nr. 01.3.2.2/486, i datës 04.10.2018, të atakuar nga paditësi si në vështrim të nenit 81G të Ligjit 04/L-102.

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së Dytë, e miraton si të drejtë dhe ligjor, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sepse, nga provat e administruara gjatë seancës së shqyrtimit kryesor ka konstatuar drejtë gjendjen faktike të çështjes. Gjithashtu, kolegji vlerëson se organi administrativ, e në rastin konkret Dogana e Kosovës, në bazë të autorizimeve ligjore nga neni 82,83 të Kodit Doganor dhe të Akcizave 03/L-109, Sektori i Kontrollit pas importues, me të drejtë ka obliguar paditësin me taksë doganore shtesë per DUD-at kontestues per periudhën kohore 2015-2017, për shkak se nuk ka tarifuar saktë mallin e importuar pjesë për makineri shpuese sandvik, duke e liruar mallin nga taksa doganore prej 10%.

Në rastin konkret e paditura duke u referuar në Mendimin për klasifikim tarifor nr...../12.09.2017 dhe nr.....0/12.09.2017 i nxjerr nga Sektori i Tarifës, ka ndërmarr veprimin per rregullimin e gjendjes duke ndryshuar Deklaratat doganore, me ç'rast kanë lindur obligimet shtesë në emër të taksës doganore dhe TVSH-së, të cilat nuk janë paguar në momentin e importit të mallit. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konfirmuar aktvendimin e të paditurës, e cila në arsyetim të aktgjykimit shpjegon bazat ligjore që e mbështesin trajtimin e klasifikimit tarifor të detyrimeve të importit kur lind një borxh doganor, autorizimet ligjore te kontrollit pas importues nga neni 82 të Kodit Doganor dhe të Akcizave 03/L109, dhe bazën ligjore nga neni 219.3 të këtij Kodi, që rregullojnë procedurat doganore të zbatuara mbi bazën e të dhënave jo të sakta apo jo të plota.

Kolegji, shqyrtoi edhe pretendimet ankimore të paditësit sipas shkaqeve ankimore, si dhe theksimet e tjera në përshkrim të ankesës, dhe të njëjtat i refuzon si të pa bazuar dhe pa ndikim për vendosjen ndryshe të çështjes, sepse nuk dëshmohet se gabimisht është aplikuar e drejta materiale e po ashtu gjendja faktike e çështjes është vërtetuar në mënyrë të plotë në gjykatën e shkallës së parë dhe në organin përfundimtar të Doganës së Kosovës. Për ti vërtetuar pretendimet se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar një gjendje faktike të gabuar sipas nenit 183 të LPK-së, paditësi është dashur të provoj informatën detyruese tarifore nga shteti eksportues dhe i origjinës së mallit, për të vërtetuar të kundërtën e Mendimeve tarifore që i ka nxjerr e paditura me rastin e ndryshimit të klasifikimit tarifor të mallit lëndor.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE PRISHTINË
Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.Sh.II.nr.484/22 datë 03.11.2022

Kryetar i kolegjit,
Krenar Berisha